



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN	
02 Nr./ Br	1223 / 23
Nr. i fq./ Br. sf	- 02 -
Data: / Datum	23.10.2023
VUSHTRRI - VUÇITRN	



KOMUNA VUSHTRRI

KRYQI I KUQ I KOSOVËS

Bazuar në nenin 5, 14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28, 04 Qershor 2008), nenin 13 paragrafi 1.4 dhe 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenit 8 paragrafi 8.1 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit 02nr.1120/23 datë 29.09.2023 për bashkëfinancim të projektit "Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri", palët:

- Komuna e Vushtrrisë përfaqësuar nga z. **Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës (këtu e tutje, Komuna)
dhe
- Kryqi i Kuq i Kosovës përfaqësuar nga znj. **Feride Hyseni**, Kryetare të Kryqit të Kuq të Kosovës (këtu e tutje, Kryqi i Kuq), me datën 23.10.2023 lidhin këtë:

ANEKS MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT

"Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri"

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është ndryshimi dhe plotësimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit 02nr.1120/23 datë 29.09.2023 për bashkëfinancim të projektit "Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri".
2. Ndryshim plotësimi i Marrëveshjes bazë ka të bëjë me pjesën tekstuale të nenit 4 paragrafi 4.2, që riformulohet si vijon: "Kryqi i Kuq i Kosovës, projektin" Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri" do t'a realizoj në pajtim me legjislacionin në fuqi që i rregullon çështjet e OJQ-ve dhe donacionet.

Neni 2
Numri i ekzemplarëve

Kjo aneks marrëveshje nënshkruhet në tri (3) kopje origjinale, dy (2) për komunën dhe një (1) për Kryqin e Kuq të Kosovës.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Kjo ^{aneks} marrëveshje të hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.


Komuna Vushtri

z. Ferit Idrizi, Kryetar

Kryqi i Kuq i Kosovës


znj. Feride Hyseni, Kryetare



Datë 23/10/2023

Datë ___ / ___ /2023